

BASHKIA TIRANË

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk

Adrese: Autostrada Tirane Durres km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13 , Kashar, Tirana.

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e Hapur, Punë publike**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF 55296 -12-28-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i Qendrës “Ten”.**

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Publikimet e mëparshme: Buletini Nr. 179 datë 30 Dhjetor 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk

Numri i NIPT-t K67106202W

Vlera: **0** (zero) lekë pa tvsh

2. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk *Numri i NIPT-it J94808405Q*

Vlera: **0** (zero) lekë pa tvsh

3 . Operatori Ekonomik “NIKA” shpk *Numri i NIPT-it J76705047U*

Vlera: 46,368,250 (dyzet e gjashtë milion e treqind gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “CAUSHI-M” shpk & “K.M.K” shpk *Numri i NIPT-it L88419801O & L78223801E*

Vlera: 46,465,867 (dyzet e gjashtë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

5. Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” shpk *Numri i NIPT-it K51501008J*

Vlera: 47,777,777 (dyzet e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “2 N” shpk *Numri i NIPT-it L31615017L*

Vlera: 49,667,293 (dyzet e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomikë ” INA” shpk *Numri i NIPT-it J61814009W*

Vlera: 51,903,819.46 (pesëdhjetë e një milion e nëntëqind e tre mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë pikë dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH

8. Operatori Ekonomikë ” CURRI” shpk *Numri i NIPT-it J67902718S*

Vlera: 53,024,272.40 (pesëdhjetë e tre milion e njëzet e katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje dyzet) lekë pa TVSH

9. Operatori Ekonomik “ASI -2ACO” shpk *Numri i NIPT-it K53002402C*

Vlera: 53,350,175.60 (pesëdhjetë e tre milion e treqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH

10. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk *Numri i NIPT-it J66926804L*

Vlera: 54,099,067.80 (pesëdhjetë e katër milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH

11. Operatori Ekonomik “NDERTIM MONTIM PATOS” shpk *Numri i NIPT-it J63229454K*

Vlera: 54,276,496.40 (pesëdhjetë e katër million e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë dyzet) lekë pa TVSH

12. Operatori Ekonomik “PEPA GROUP GROUP” shpk *Numri i NIPT-it L42215009L*

Vlera: 57,464,103.40 (pesëdhjetë e shtatë million e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tre pikë dyzet) lekë pa TVSH

13. Operatori Ekonomikë “BE-IS” shpk *Numri i NIPT-it K97006004D*

Vlera: 59,060,270 (pesëdhjetë e nëntë million e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk

Numri i NIPT-t K67106202W

Për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik “ELDA VL” shpk, ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik ,vetëm ofertë ekonomike përkatësisht me vlerë zero, të pashoqëruar me dokumentacionin e duhur ligjor dhe teknik. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacion ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik “ELDA VL” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë te pavlefshme.

2. Operatori Ekonomik “SENKA” shpk *Numri i NIPT-it J94808405Q*

Për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik “SENKA” shpk, ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik ,vetëm ofertë ekonomike përkatësisht me vlerë zero, të pashoqëruar me dokumentacionin e duhur ligjor dhe teknik. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacion ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit

ekonomik “SENKA” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë te pavlefshme.

3. Operatori Ekonomik “NIKA” shpk Numri i NIPT-it J76705047U

Për arsytet e mëposhtme:

OE nuk plotëson, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

OE “NIKA” shpk, ka paraqitur në SPE, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST, ka deklaruar ndër të tjera edhe mjetet si më poshtë:

- Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton për secilin kamion 3copë;
- Vinç me kosh 1 copë;
- Eskavator me goma 0.5 m3 2 copë

OE “NIKA” shpk, ka deklaruar mjetin Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton, me targë KO4982B me nr. Leje qarkullimi KOD1624012, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep2411 dhe nr.kol 910 dt.22.02.2021.

Po këtë mjet Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton, me targë KO4982B, me nr. Leje qarkullimi KOD1624012, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep7477 dhe nr.kol 1520 dt.13.09.2021, e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “INA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

OE “NIKA” shpk, ka deklaruar mjetin Vinç me kosh, me targë AB954AM me nr. Leje qarkullimi KOF0402916, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep2411 dhe nr.kol 910 dt.22.02.2021.

Po këtë mjet Vinç me kosh , me targë AB954AM me nr. Leje qarkullimi KOF0402916, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep3792 dhe nr.kol 2104 dt.05.09.2020, e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “INA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë e prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

OE “NIKA” shpk, ka deklaruar mjetin Eskavator me goma 0.5 m3, me targë ADMT67 me nr. Leje qarkullimi KOD1167111, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep.3111 dhe nr.kol 1185 dt.05.03.2021.

Po këtë mjet Eskavator me goma 0.5 m3 , me targë ADMT67 me nr. Leje qarkullimi KOD1167111, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep3792 dhe nr.kol 2104 dt.05.09.2020, e ka

deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “INA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë e prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

KVO, është para rastit ku dy operatorë ekonomikë, pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi kanë deklaruar të njëjtat mjete. Pra këto mjete të marra me qera janë deklaruar në më shumë se një Operator ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

Duke ju referuar edhe vendimmarrjeve të KPP, KVO gjendet përballë një kontrate qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëtit mjet dy operatorëve të ndryshëm ekonomikë. KVO gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cilit nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjetit, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

KVO nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratave respektive të qerasë të cilat janë lidhur rregullisht përpara noterit publik. Në vijim të këtij arsytimi KVO, gjykon se asnjë prej operatorëve ekonomik nuk krijon bindjen lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknike.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

4 . Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “CAUSHI-M” shpk & “K.M.K” shpk Numri i NIPT-it L884198010 & L78223801E

Për arsyet e mëposhtme:

BOE, nuk plotësojnë Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit pika 2.4.1 *Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Kontratë pune e vlefshme; b)Diplomë (Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit, pasi OE Caushi M shpk ka deklaruar Z. F.Sh si drejtues teknik ,por nga verifikimi në formularin e vetdeklarimit (shtojca nr 8) rezulton se F.SH është me profesion ing Mekanik dhe jo ing ndertimi.Drejtuesi teknik në këtë procedurë duhet të ishte ing ndertimi sipas legjislationit në fuqi.*

Gjithashtu OE K.M.K SHPK pjesë e BOE ka deklaruar Znj. L.SH si drejtues teknik ,por nga verifikimi në formularin e vetdeklarimit (shtojca nr 8) rezulton se Znj.L.SH është me profesion

ing Mekanike dhe jo ing ndertimi. Drejtuesi teknik ne kete procedure duhet te ishte ing ndertimi sipas legjislacionit ne fuqi.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

5. Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” shpk Numri i NIPT-it K51501008J

Për arsyet e mëposhtme:

-OE nuk plotëson, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: Autobetoniere dy copë pasi OE, në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8, ka deklaruar vetëm një mjet Autobetoniere , perkatesisht mjetin me targa AA 794 CP.

-OE “SIRETA 2F” shpk, nuk ploteson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, te Dokumentave Standarte te Tenderit pika 2.4.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si me poshte:

-1 (nje) punonjës teknik ndertimi, 2 (dy) punonjës elektriciste, 2 (dy) punonjës hidraulike, 1 (nje) punonjës Mekanik , 2 (dy) punonjes karpentier

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e sipercituar, emrin, profilin e punes dhe rolin që ka pranë shoqërisë.

OE, nuk ka deklaruar asnjë punonjës mekanik ne formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

6. Operatori Ekonomik “2N” shpk Numri i NIPT-it L31615017L

Për arsyet e mëposhtme:

OE nuk plotëson, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

OE “2N” shpk, ka paraqitur në SPE, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST, ka deklaruar ndër të tjera edhe mjetin si më poshtë:

-Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton AA463D Y, marrë me kontratë qeraje Nr.Rep 7566 dhe Nr.Kol 3067, me afat 16.10.2021- me afat 2 vjecar

Referuar pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST, citoj:

Ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperem, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve .

Nga verifikimi qe KVO,i bëri Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, rezulton se: Mjeti Kamion Veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton AA463D Y, marrë me kontratë qeraje Nr.Rep 7566 dhe Nr.Kol 3067 i përfundon afati i vlefshmërisë më datë 16.10.2023. Afati i kontratës së qerasë nuk është e vlefshme deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Grafiku i punimeve për objektin e prokurimit: Ndërtim i Qendres “TEN”, është 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

7. Operatori Ekonomikë ” INA” shpk *Numri i NIPT-it J61814009W*

Për arsyet e mëposhtme:

OE nuk plotëson, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.8. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

OE “INA” shpk, ka paraqitur në SPE, Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kriterëve të vecantë të kualifikimit të DST, ka deklaruar ndër të tjera edhe mjetet si më poshtë:

- *Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumii 15(pesëmbëdhjetë) ton për secilin kamion 3copë;*
- *Vinç me kosh 1 copë;*
- *Eskavator me goma 0.5 m3 2 copë*

OE “INA” shpk, ka deklaruar mjetin Kamion vetshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton, me targë KO4982B, me nr. Leje qarkullimi KOD1624012, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep7477 dhe nr.kol 1520 dt.13.09.2021.

Po këtë mjet Kamion vetshkarkues kapaciteti mbajhtës minimum 10(dhjetë) ton dhe maksimumi 15(pesëmbëdhjetë) ton, me targë KO4982B me nr. Leje qarkullimi KOD1624012, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep2411 dhe nr.kol 910 dt.22.02.2021, e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kritereve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “NIKA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë e prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

OE “INA” shpk, ka deklaruar mjetin Vinç me kosh, me targë AB954AM me nr. Leje qarkullimi KOF0402916, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep3792 dhe nr.kol 2104 dt.05.09.2020.

Po këtë mjet Vinç me kosh , me targë AB954AM me nr. Leje qarkullimi KOF0402916, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep2411 dhe nr.kol 910 dt.22.02.2021, e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kritereve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “NIKA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë e prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

OE “INA” shpk, ka deklaruar mjetin Eskavator me goma 0.5 m3, me targë ADMT67 me nr. Leje qarkullimi KOD1167111, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep3792 dhe nr.kol 2104 dt.05.09.2020.

Po këtë mjet Eskavator me goma 0.5 m3, me targë ADMT67 me nr. Leje qarkullimi KOD1167111, mjet i marrë me kontratë qeraje nr. Rep.3111 dhe nr.kol 1185 dt.05.03.2021, e ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 dhe në plotësim të pikës 2.8 të kritereve të vecantë të kualifikimit të DST edhe Operatori Ekonomik “INA” shpk, i cili është pjesëmarrës në këtë procedurë e prokurimi me objekt: “Ndërtim i Qendres “TEN”.

KVO, është para rastit ku dy operatorë ekonomikë, pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi kanë deklaruar të njëjtat mjete. Pra këto mjete të marra me qera janë deklaruar në më shumë se një Operator ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

Duke ju referuar edhe vendimmarrjeve të KPP, KVO gjendet përballë një kontrate qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëtit mjet dy operatorëve të ndryshëm ekonomikë. KVO gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cilit nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjetit, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

KVO nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratave respektive të qerasë të cilat janë lidhur rregullisht përpara noterit publik. Në vijim të këtij arsyetimi KVO, gjykon se asnjë prej operatorëve ekonomik nuk krijon bindjen lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknike.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

8.Operatori Ekonomik “ASI -2ACO ” shpk Numri i NIPT-it K53002402C

Për arsyet e mëposhtme:

OE nuk ploteson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit pika 2.4.1 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Kontratë pune e vlefshme; b)Diplomë (Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit, pasi OE nuk ka paraqitur në SPE deklaratë për drejtuesin teknik për këtë procedurë sipas kërkesës në DST.

OE nuk ploteson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit pika 2.8 germa b) oe duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.dhe pika c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deshmon se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fituese nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane, pasi OE nuk ka paraqitur në SPE deklaratat sipas kërkesës në DST për pikat b dhe c.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

9. Operatori Ekonomik “CURRI” shpk Numri i NIPT-it K027272020

Për arsyet e mëposhtme:

OE “CURRI” shpk, në mbështetje të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, më datë 21.02.2023, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i kërkoi ofertuesit të kualifikuar, i pari Operatorit Ekonomik “CURRI” shpk dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

Operatori ekonomik “CURRI ” shpk, nuk ka depozituar, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë dokumentacionin e kërkuar, për procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim i Qendrës “Ten” me Nr. REF 55296 -12-28-2022

10. Operatori Ekonomik “INERTI” shpk Numri i NIPT-it J66926804L

Për arsyet e mëposhtme:

OE, nuk plotëson, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-Eskavator me goma 0.5 m3 dy copë

-Autobot Uji 1 copë

OE “INERTI” shpk, në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8, ka deklaruar dy mjete Eskavator me goma 0.5 m3, përkatësisht mjeti me targë ABMT79 dhe mjeti me targë AB683CR.

Gjithashtu OE, ka deklaruar në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8 mjetin Autobot uji me targë AA219FV. Nga verifikimi që ju bë formularit të vetdeklarimit, rezulton se dy mjete, Eskavator me goma 0.5 m3, me targa ABMT79 dhe AB683CR dhe mjeti Autobot uji me targe AA219FV, janë deklaruar dhe shpallur fitues në procedurën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, me objekt: “Ndërtimi i urës në lagjen Fezaj, fshati Zall Bastar”.

Referuar kriterëve të vecanta të kualifikimit, pika 2.8 gërma c, ku citohet se:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

11. Operatori Ekonomik “Ndërtim Montim Patos” shpk Numri i NIPT-it J63229454K

Për arsyet e mëposhtme:

OE nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit pika 1/d Ofertuesi duhet të paraqesë: *d. Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2 ,pasi OE nuk ka paraqitur në SPE shtojcën nr 2.*

OE, Alba Konstruksion në cilësinë e subjektit mbeshtetes nuk plotëson, kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme: *pasi OE, në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8, ka deklaruar vetëm një mjet eskavator me goma me fature doganore dt 23.01.2009 dhe 01.12.2014. Për këto mjete OE duhet të deklaronte lejen e qarkullimit dhe targetin përkatës.*

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

12. Operatori Ekonomikë “BE-IS shpk” shpk Numri i NIPT-it K97006004D

Për arsyet e mëposhtme:

OE nuk plotëson, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika **2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:** Eskavator me goma 0.5 m3 dy copë pasi OE, në formularin e vetdeklarimit, shtojca 8, ka deklaruar vetëm një mjet Eskavator me goma 0.5 m3, perkatesisht mjetin me targa AGMT42.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**PEPA GROUP GROUP**” shpk, Numri i NIPT-it L42215009L, me adresë: Autostrada Tirane Durres km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13, Kashar, Tirana, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **57,464,103.40** (pesëdhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tre pesje dyzet) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranw, Drejtoria e Prokurimeve*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar , tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj), siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)

PO JO X